

"Evropa është kundër Islamit Fanatik"

Në shfaqjen e tij të drejtpërdrejtë në Kanal A9 TV, Adnan Oktar iu përgjigj pretendimit se Evropa është kundër Islamit, dhe tha: "Evropa nuk është e krishterë, por ateiste. Në Evropë kishat janë bosh. Por Evropa nuk është kundër Islamit. Ata janë kundër fanatizmit dhe cilësisë së ulët. "

Adnan Oktar më tej shtoi, " Evropa nuk do të dojë një jetë që do ta turbullojë, një jetë në të cilën çdo gjë është e ndaluar. Në fanatizëm, nga ana tjetër, çdo gjë është e ndaluar. Nëse Evropa do ta shihte llojin e Islamit në mënyrën se si Shokët e Profetit tonë (saas) jetuan, nëse ata do e shihnin cilësinë e Islamit, ata menjëherë do ta pranonin atë "

Këtu janë deklaratat e Adnan Oktar.:

"A e dini se kundër cilit lloj të Islamit Evropës është kundër? (Ata janë) kundër Islamit fanatik. Nën maskën e Islamit, disa muslimanë përmendin copëtimin e njerëzve, ata thonë se do të vrasin të gjithë ata që nuk i kryejnë lutjet. Ata thonë se të krishterët duhet të shtyhen mënjanë në rrugë. Ata thonë se gurët do të informojë për hebrejtë dhe ata do ti presin(copëtojnë) të gjithë, gratë dhe fëmijët. Kjo është ajo që Evropianët urrejnë. Evropa urren fanatikët, përndryshe pse ata do të ndjeheshin të shqetësuar nga cilësia e muslimanëve?

Për shembull, më parë i kemi quajtur Freemasonë, tani ne i thërrasim përsëri. Ata vijnë me krenari dhe na afrohen me dashuri. Njerëzit largohen nga fanatikët. Pse ata do të largoheshin nga muslimanët? Ata largohen jo nga muslimanët por nga tipat e pamëshirshëm dhe psikopat. "

Nëse Islami siç kanë jetuar shokët e Profetit tonë (saas) do të ishte i pranishëm, e gjithë Evropa do ta pranonte atë. Për shembull Evropianët duan të qeshin, por fanatikët thonë: "Ju nuk mund të qeshni!" Gratë Evropiane duan të jenë të bukura dhe me stil, por fanatikët thonë, "ata do të vrasin të gjithë ata që nuk e falin namazin ose që nuk japin lëmoshë. A do ta pranonin ato një model të tillë?

Por në qoftë se do ishte kjo situatë: ka shumë zonja të hirshme, me cilësi të lartë. Janë ato zonjat veshur me shami dhe ato që nuk e kanë veshur shaminë, por ato të gjitha vishen në një mënyrë shumë të civilizuar dhe të denjë. Çdo njeri është i qeshur, i dashur, i sigurt dhe shumë i pastër. Tavolinat e tyre dhe shtëpitë janë të cilësisë më të lartë. Pse nuk do ta pranonin ata këtë? Krishterimi nuk është një çështje për Evropën. Evropa nuk është fare e krishterë. Është e vështirë të gjeni ndonjë të krishter në Evropë. Krishterimi ka vdekur në Evropë. Shkoni dhe shikoni kishat, ato janë të gjitha bosh. Evropianët e konsiderojnë krishtërinim si legjendë. Rinia evropiane nuk beson në të, në asnjë mënyrë. Ateizmi dhe

mungesa e fesë është përhapur gjerë në Evropë. Kishat në Evropë mbyllen njëra pas tjetrës. Shërbimet mbahen vetëm kur ka vdekje ose për dasma. Përveç këtyre

shërbimeve, kishat janë më së shumti bosh. Rrjedhimisht, Krishtërimi nuk i intereson Evropës. Sistemi i fanatizmit që ka ndodhur si rezultat i keqpërdorimit të Islamit është i tmerrshëm.

<https://www.harunyahya.info/sq/artikujt/evropa-eshte-kunder-islamit-fanatik>